



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
Drejtoria e Prokurimeve

Date 28/02/2020

Nr _____ Prot

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date 28.02.2020

Nga: *Bashkia Korçë, Bulevardi “Shën Gjergji”, 082 243353.*

Për: *Shoqerine “Merolli Oil”sh.pk, adresa: Korçë, Vloçisht – Libonik.*

Procedura e prokurimit: *Procedure e hapur*

Objekti: *“Blerje karburanti”*

Loti 1 Naftë

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-47416-01-14-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim furnizimin me naftë per nevoja te Bashkise Korçë dhe institucioneve te varesise.*

Fondi limit: **Loti 1 Naftë = 46.177.333 lekë**

Burimi i financimit: *Te ardhurat e bashkise*
Shpenzim

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: **07.02.2020**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] –

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me keto marzhe fitimi te ofruara:

1. Shoqeria “Merolli Oil” sh.p.k , NIPT K04005080H
Marzhi i fitimit 2.35%(dy pike tridhjetë e pesë për qind)

2. Shoqeria “Olsi” sh.p.k , NIPT J63423463I
Marzhi i fitimit 4.8%(kater pike tete për qind)

3. Shoqeria “Aroil Company” sh.p.k , NIPT L44324002H

Marzhi i fitimit 5.5%(pese pike pese perqind)

4.Bashkimi i shoqerive “Eroil” sh.a , NIPT L32230076S & “Das Oil” sh.p.k NIPT L52230020G

Marzhi i fitimit 7 %(shtate perqind)

5. Shoqeria “Kastrati” sh.p.k , NIPT J61813529P

Marzhi i fitimit 7.2%(shtate pike dy perqind)

* * *

Jane s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Shoqeria “ Olsi ” shpk per arsye se:

Nuk ploteson kriterin e kualifikimit te vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 9,pika II.Kritere te vecana te pranimit lidhur me kapacitetin teknik,pika "b-*Leje per ushtrim aktiviteti 24 ore per te pakten nje stacion shitjeje me pakice te lendes djegese karburante brenda Bashkise Korçë shoqeruar me Autorizimin per hyrje dalje ne rruge per kete stacion shitje.*"per arsye se ofertuesi nuk ka paraqitur *Leje per ushtrim aktiviteti 24 ore per stacionin e shitjes te ndodhur ne adresen “Lagjia Nr 18 Rr Muzakajt ne zona industriale .*

Per stacionin e shitjes te ndodhur ne adresen “Lagjia Nr 18 Rr Muzakajt ne zona industrial” eshte paraqitur vetem Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante” dhe autorizim per hyrje dalje ne rruge.

Ofertuesi ka paraqitur leje per zhvillim aktiviteti 24 ore per stacionin e ndodhur ne adresen “Korce, Mollaj,Stacion Karburanti,Fshati Dvoran” por per kete stacion nuk ka paraqitur Autorizim per ushtrim aktiviteti “Tregeti me pakice te lendeve djegese Karburante” ose Licence per tregetimin me pakice te karburanteve, gazit te lengshem naftes per automjet,vajrave lubrifikant per perdorim nga konsumatorët fundore” te leshuar nga Bashkia Korçë dhe as autorizimin per hyrje dalje ne rruge.

2. Bashkimi i shoqerive “ Eroil ”shpk “ Das Oil ”per arsye se:

I.Shoqeria Eroil sh.a ka paraqitur nje marreveshje bashkepunimi me shoqerine "Das oil " Sh.p.k e cila nuk eshte hartuar ne perputhje me VKM Nr 914 date 29.12.2014 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” neni 74 pika 1 , 2,3 ku percaktohet shprehimisht se:

“1.Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të percaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të percaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me procure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. ...”

3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, tëparashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të percaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në akt marrëveshje.”

Marreveshja e bashkepunimit eshte bere ne daten 29.05.2019 pra nuk eshte krijuar per kete procedure

prokurimi . Ne kuptim te dispozitave ligjore te percaktuara me siper marreveshja e bashkepunimit duhet te krijohet per nje procedure prokurimi konkrete ku te jene percaktuar elementet konkrete qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi qe me pas te vijohet me vleresimin e kerkesave te percaktuara ne dokumentat e tenderit per cdo anetar te bashkimit.

Per me teper ne aktmarreveshje pika 9 eshte percaktuar qe secila pale mund te nenkontraktoje 10% nderkohe qe ne nenin 75 pika 4 te VKM 914 eshte percaktuar shprehimisht se “ *Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnëpunët/shërbimet/mallrat ose një pjesë të tyre që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues, si dhe emrin e nënkontraktorit.*”

Gjithashtu mungon edhe autorizimi per hyrje dalje per stacionin e shitjes ,ne kundërshtim me kriterin e kualifikimit te vendosur ne dokumentat e tenderit,shtojca 9,pika II.Kritere te vecana te pranimit lidhur me kapacitetin teknik,pika "***b-Leje per ushtrim aktiviteti 24 ore per te pakten nje stacion shitjeje me pakice te lendes djegese karburante brenda Bashkise Korçë shoqeruar me Autorizimin per hyrje dalje ne rruge per kete stacion shitje.***"

II. Shoqeria Eroil sh.a dhe Das Oil sh.p.k ne deklaratat mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme nuk kane vendosur te dhenat e kerkuara ne DST per personat e deklaruar ne to.

Edhe mbas kerkeses te kryetarit te KVO ,date 13.02.2020,derguar nepermjet sistemit te APP,serisht nuk jane vene ne dispozicion te dhenat e kerkuara.

Si rrjedhim KVO nuk mundi te bente verifikimin e gjendjes gjyqesore te personave te deklaruar ne shtojcen - Deklaraten mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme,sipas parashkimeve te bera ne nenin 45 te Ligjit Nr 9643 date datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe njoftimin e përbashkët të Agjencisë të Prokurimit Publik Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1Prot datë 01.02.2019.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Shoqerine “Merolli Oil ”shpk, me adrese: Korçë, Vloçisht-Libonik**, se oferta e paraqitur per **Lotin 1 Naftë**, me një marzh fitimi prej **2.35%(dy pike tridhjetë e pese perqind)**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

* * *

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë **Bashkise Korçë**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi por jo me vone se 5 dite nga kerkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet ne perputhje me nenin 58 të ligjit për prokurimet publike Nr 9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 20.02.2020

Ankesa: JO

Konceptoi:M.Stena

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO**